

# Trusti



FONDI I KURSIMEVE PENSIONALE I KOSOVËS

BULETINI TREMUJOR  
NR 61 -- VITI XVI -- TM1 2023

# TRUSTORJA

**PERFORMANCA - PORTOFOLI STANDARD**

PERIUDHA	1 MUAJ	3 MUAJ	VITI AKTUAL	3 VJET	5 VJET	NGA THEMELIMI
REZULTATI	-1.87%	-0.11%	-0.11%	+12.83%	+13.28%	+62.50%
BENÇMARKU*	-0.39%	+0.55%	-0.39%	+19.81%	+24.61%	+67.28%

\*Indeksi i harmonizuar i çmimeve të konsumit sikurse i publikuar nga Agjencia e Statistikave e Kosovës.

**LËVIZJET MUJORE**

MUAJI	NDRYSHIMI I ÇMIMIT TË AKSIONIT		KTHIMI BRUTO STANDARD (MLN)	KTHIMI BRUTO KONSERVATIV (MLN)
	STANDARD	KONSERVATIV		
Janar	+1.84%	+0.29%	€43.37	€0.32
Shkurt	-0.04%	+0.26%	€(0.41)	€0.34
Mars	-1.87%	+0.29%	€(43.58)	€0.38
<b>Tremujori</b>	<b>-0.11%</b>	<b>+0.83%</b>	<b>€(0.61)</b>	<b>€1.04</b>

**KONTRIBUIMI**

	KONTRIBUTET E REJA STANDARD (MLN)	KONTRIBUTET E REJA KONSERVATIV (MLN)	LLOGARI TË REJA	LLOGARI AKTIVE
Janar	€23.61	--	2,293	433,932
Shkurt	€20.84	--	2,704	308,377
Mars	€21.71	--	2,742	331,276
<b>Tremujori</b>	<b>€66.16</b>	<b>--</b>	<b>7,737</b>	<b>357,862*</b>

\*Mesatarja tremujore

**PENSIONIMET**

	TË PENSIONUAR	SHUMA E TËRHEQUR
Janar	585	€3,694,614
Shkurt	592	€3,552,858
Mars	769	€4,619,916
<b>Tremujori</b>	<b>1,946</b>	<b>€11,867,388</b>

**PËRMBLEDHJE SHIFRASH**

	<b>FUNDI TM1 2023</b>	<b>FUNDI TM4 2022</b>
ÇMIMI I AKSIONIT STANDARD	€1.6250	€1.6268
ÇMIMI I AKSIONIT KONSERVATIV	€2.0759	€2.0588
MJETET NETO NËN MENAXHIM STANDARD	€2,336,447,734	€2,316,363,920
MJETET NETO NËN MENAXHIM KONSERVATIV	€122,307,600	€94,812,043
NUMRI I LLOGARIVE GJITHSEJ	800,778	792,995
NUMRI I LLOGARIVE AKTIVE	331,276	428,891
TARIFA INVESTUESE PËR TREMUJORIN	€1,851,790	€1,858,973
TARIFA OPERACIONALE PËR TREMUJORIN	€306,466	€331,130
INVESTIMET NË KOSOVË	€677,973,955	€690,671,577
INVESTIMET JASHTË	€1,742,221,475	€1,689,250,011
TË PAINVESTUARA (NË BQK)	€39,596,425	€32,130,596

## PLASMANET DHE PERFORMANCA NË FUND TË TM1 2023

MENAXHUESI   FONDI	NUMRI ISIN / LLOJI INVESTIMIT	PLASMANET FUNDI I TM1 2023	KTHIMI BRUTO NË INVESTIME
Vanguard GSIF	IE00B03HD316	€1,153,041.46	€75,298.63
Nordea 1-SRF	LU0539147214	€228,853,400.70	€4,784,803.71
Nordea 1-GSEF	LU0257969260	€152,335,264.08	€3,872,348.60
BNY Mellon RRF	IE00B504KX99	€197,637,259.53	€(2,534,826.58)
Amundi Euro Liquidity-Rated SRI	FR0007038138	€302,211,732.92	€2,094,457.50
Schroder ISF Global Sustainable Growth	LU2305367323	€24,954,035.12	€413,543.93
BNP Climate Impact	LU0406802768	€24,942,313.93	€(258,880.14)
WisdomTree WTI Crude Oil ETC	GB00B15KXV33	€22,159,829.68	€(831,035.52)
SPDR S&P Euro Dividend Aristocrats UCITS ETF	IE00B5M1WJ87	€20,904,191.34	€(90,534.35)
WisdomTree Industrial Metals	GB00B15KYG56	€28,457,599.64	€(1,607,007.02)
iShares Core Dividend Growth ETF	US46434V6213	€34,096,778.32	€(444,380.08)
iShares Global Clean Energy ETF	US4642882249	€21,725,609.88	€(423,462.51)
US Infrastructure ETF	US37954Y6730	€62,175,172.02	€3,178,974.11
US Infrastructure Dev ETF	US46435U7138	€60,687,974.34	€686,866.61
iShares Edge S&P 500 Minimum Volatility	IE00BYX8XD24	€21,358,544.00	€32,540.21
iShares MSCI Glob. Metals&Mining Producers ETF	US46434G8481	€65,122,047.13	€(4,859,997.62)
Lyxor EUR 2-10Y Inflation Expectations ETF	LU1390062245	€41,656,681.00	€823,219.02
Vanguard Value ETF	US9229087443	€114,987,126.48	€(3,824,619.80)
Invesco KBW Bank ETF	US46138E6288	€53,738,714.06	€(13,416,923.61)
iShares Edge MSCI Europe Val. Factor ETF	IE00BQN1K901	€84,742,181.15	€5,493,242.28
Lyxor EURO STOXX Banks ETF	LU1829219390	€57,204,943.79	€3,633,949.01
SPDR S&P Oil & Gas Explor. & Prod. ETF	US78468R5569	€52,605,977.10	€(4,289,764.01)
WisdomTree Physical Gold – EUR Daily Hedged	JE00B8DFY052	€39,653,180.63	€2,658,118.87
SPDR MSCI Europe Energy	IE00BKWQ0F09	€28,857,877.40	€(657,882.31)
Thesari i Republikës së Kosovës <sup>1)</sup>	Letra me vlerë të Qeverisë	€549,815,657.08	€3,453,318.77
Banka në Kosovë <sup>1)</sup>	Depozita bankare	€128,158,297.87	€732,928.82
BQK - të gatshme	Të paimvestuara	€36,687,061.40	€17,646.95
Erste Bank (Broker)	Të paimvestuara	€2,903,833.04	€5,142.65
Të hyra të tjera (nga dividendat)	--	--	€1,710,427.15
Paraja në dorë dhe në tranzit	Të paimvestuara	€5,530.65	--
<b>GJITHSEJ</b>		<b>€2,459,791,855.74</b>	<b>€427,513.27</b>

<sup>1)</sup> Këto janë investime me afat të caktuar maturimi.

## LAJME

<p><b>SQARIM PËR GJENDJEN E INVESTIMEVE TË FKPK-SË</b></p>	<p>FKPK ka dalë më deklaratë publike më 21 mars 2023, për të sqaruar gjendjen e investimeve të institucionit, pas disa raportimesh në media që kanë ngritur shqetësimin e kontribuuesve dhe publikut të gjerë. Në atë deklaratë është thënë se:</p> <p>Mjetet nën menaxhim të FKPK-së trajtohen në dy portofole investuese:</p> <p>1) Portofolin Standard (ku përfshihen të gjithë kontribuuesit deri në moshën 63 vjeçare). 2) Portofolin Konservativ (ku përfshihen të gjithë kontribuuesit e moshës 63 vjeçare e më shumë).</p> <p>Mjetet e kontribuuesve të Portofolit Standard kanë në përbërje investimet që kanë kthim potencial dhe risk më të lartë, andaj edhe kanë luhatshmëri më të lartë. Për shkak të situatës së krijuar në tregjet financiare prej 10 marsit e deri më 17 mars 2023, ku disa banka të rëndësishme për ekonominë globale shfaqen vështirësi financiare duke afektuar tregjet, investimet e FKPK-së të Portofolit Standard po ashtu janë përballuar me luhatje të forta. Kjo bëri që i gjithë kthimi pozitiv nga investimet në muajt janar e shkurt 2023 të zhvlerësohet dhe për periudhën 1 janar 2023 e deri më 20 mars 2023 (për datën e fundit që i kemi të dhënat në dispozicion) Portofoli Standard e ka një rënie prej -1.5% ose një kthim bruto prej rreth -36 milionë euro.</p> <p>Ndërsa për të njëjtën periudhë, Portofoli Konservativ ka një kthim pozitiv prej rreth +0.7% ose rreth 800 mijë euro, kjo meqë investimet e këtij portofoli janë në instrumente me kthim potencial dhe risk ndjeshëm më të ulët. Ky është edhe portofoli nga i cili pensionohen kontribuuesit e moshës 63 vjeçare e lartë, të cilët nuk prekën nga luhatjet në tregjet financiare dhe edhe nën këto kushte kanë kthim pozitiv për vitin 2023. Kjo është edhe kategoria më e ndjeshme e kontribuuesve në këso situata, dhe kjo zgjidhje për ta ka dhënë efekt shumë të kënaqshëm.</p> <p>Bazuar në përvojën e institucionit dhe përbërjes së portofolit aktual investues, nuk mund të themi që mjetet e FKPK-së si tërësi janë të rrezikuara, por gjithsesi institucioni është në gjendje të vështirë pa organin kryesor vendimmarrës sipas legjislacionit në fuqi.</p> <p>Njëkohësisht duam të sqarojmë se FKPK-ja i ka kryer të gjitha detyrat me kohë, duke e njoftuar disa herë Komisionin Përzgjedhës për afatet e skadimit të mandatit të Bordit Drejtues të FKPK-së. Po ashtu FKPK-ja, sipas kërkesës së Komisionit, e ka shpallur konkursin për anëtarë të Bordit Drejtues dhe pas mbarimi të konkursit i gjithë dokumentacioni për kandidatët për anëtarë të Bordit Drejtues është dorëzuar në BQK.</p>
<p><b>SKADON MANDATI I ANËTARËVE TË BORDIT DREJTUES</b></p>	<p>Më 28 shkurt 2023 të gjithë anëtarëve të Bordit Drejtues të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës (FKPK) iu ka përfunduar mandati. Pra nga sot, 1 mars 2023, FKPK-ja është pa Bord Drejtues.</p> <p>Për shkak se vendimmarrja rreth investimeve është përgjegjësi ligjore/fiduciare ekskluzive e Bordit Drejtues, e cila nuk mund të delegohet, mungesa e Bordit Drejtues ia pamundëson institucionit të ndërmarrë çfarëdo vendimi për investimin e mjeteve pensionale, si për investimet e mjeteve pensionale jashtë Kosovës ashtu edhe për ato brenda Kosovës. Pra, të gjithë investimet aktuale nuk mund të ndryshohen (shtohen ose tërhiqen), ashtu sikurse të gjitha kontributet e reja pensionale që arkëtohen – nuk mund të investohen.</p> <p>Për të mos lënë zbrastësi vendimmarrëse me pasoja (të cekura më lart) ndaj mjeteve pensionale, me Ligj kërkohet hapja e konkursit me kohë në mënyrë që të ketë Bord Drejtues funksional në vazhdimësi.</p> <p>Për rikujtim, konkursi për anëtarë të Bordit Drejtues në FKPK është mbyllur më 23 dhjetor 2022. Me vendim të Komisionit Përzgjedhës, konkursi i datës 23 dhjetor 2022 është anuluar. Me disa ndryshime në procedurën e aplikimit, konkursi është rishpallur më 18 prill 2023 dhe i njëjti është mbyllur më 5 maj 2023. Komisioni Përzgjedhës do të vazhdojë shqyrtimin e këtij procesi, sikurse përcaktohet edhe në Ligjin për fondet pensionale në Kosovë.</p>

**PUBLIKON**

Fondi i Kursimeve Pensionale i Kosovës  
Prill 2023

**AUTOR**

Jeton Demi

**ADRESA**

Rr. "Agim Ramadani" #182-184 10000 Prishtinë, Kosovë

**E-MAIL & UEB**

[info@trusti.org](mailto:info@trusti.org) | [www.trusti.org](http://www.trusti.org)

**Facebook**

TrustiPensional

**Youtube**

Fondi Pensional i Kosovës